



Njëherë Profeti (paqja qoftë mbi të!) doli të fliste me ne dhe ne i thamë: 'O Profet i Allahut, e dimë si të lutemi për paqe për ty, por deshëm të dimë si të lutemi për bekime për ty?!'

Abdurrahman ibn ebi Lejla ka treguar se Ka'b ibn Uxrah e ka takuar dhe i ka thënë: "A të të jap një dhuratë? Njëherë Profeti (paqja qoftë mbi të!) doli të fliste me ne dhe ne i thamë: 'O Profet i Allahut, e dimë si të lutemi për paqe për ty, por deshëm të dimë si të lutemi për bekime për ty?!' Ai tha: 'Thoni: 'Allāhumme šal-li 'alā Muḥam-medin ue alā āli Muḥammed kemā šal-lejte 'alā Ibrāhīme ue 'alā āli Ibrāhīm, inneke ḥamīdun Mexhīd. All-llāhumme bārik 'alā Muḥammedin ue 'alā āli Muḥammed, kemā bārakte alā Ibrāhīme ue 'alā āli Ibrāhīm, inneke Ḥamīdun Mexhīd.'" (O Allah, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç bekoje Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Ti je i Përlëvdur dhe i Lartmadhëruar! O Allah, begatoje Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu siç begatove Ibrahimin dhe familjen e tij. Ti je i Përlëvdur dhe i Lartmadhëruar).

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Sahabët e pyetën Profetin (paqja qoftë mbi të!) për mënyrën e dërgimit të salavateve mbi të në uljen e teshehudit, pasi mënyrën e dërgimit të selamit e kishin mësuar më parë; "Es-selamu alejke ejuhen-nebijju ue rahmetullahi ue berakatuhu." Profeti (paqja qoftë mbi të!) u tregoi atyre mënyrën e dërgimit të salavateve, kuptimi i të cilave është: "Allāhumme šal-li 'alā Muḥam-medin ue alā āli Muḥammed" D.m.th: lavdëroje në praninë e kuvendit të lartë Muhamedin bashkë me pasuesit e tij dhe të afërmit e tij besimtarë. "kemā šal-lejte 'alā Ibrāhīme ue 'alā āli Ibrāhīm." Begatoje Muhamedin (paqja qoftë mbi të!) ashtu siç begatove familjen e Ibrahimit, familja e të cilit përbëhej nga Ibrahim, Ismaili, Is'haku, pasardhësit dhe pasuesit e tyre besimtarë. "Inneke Ḥamīdun Mexhīd." D.m.th: i Përlëvdur në qenien, cilësitë dhe veprimet e Tua dhe i Lartmadhëruar në madhësinë, sundimin dhe mirësinë Tënde. "Allāhumme bārik 'alā Muḥammedin ue 'alā āli Muḥammed, kemā bārakte alā Ibrāhīme ue 'alā āli Ibrāhīm" d.m.th: jepi atij mirësinë dhe begatinë më të madhe, shtojë atë për të dhe bëj që ajo të jetë e pashterueshme!

النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY

